



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Rezultatet e vlerësimit nga pyetësi "Dekani – Mësimdhënësin"

Viti akademik 2024/2025

1. Qëllimi i vlerësimit

Qëllimi i vlerësimit **“Dekani – Mësimdhënësin”** është që, dekani të vlerësojë performancën dhe angazhimin e mësimdhënësit në aspektet akademike, administrative dhe të marrëdhënieve me studentët. Pra, qëllimi kryesor i pyetësorit është që dekani të ofrojë një pasqyrë mbi performancën e mësimdhënësit, duke përfshirë cilësinë e mësimdhënies, përfshirjen e studentëve, aktivitetin shkencor dhe kontributin ndaj universitetit, si dhe aspektet e sjelljes profesionale.

2. Metodologjia e punës

Ashtu siç është e paraparë në Kalendarin e aktiviteteve të Udhëzuesit për sigurim të cilësisë, në fund të secilit vit akademik, dekani vlerëson mësimdhënësit e rregullt dhe të angazhuar përmes pyetësorit **“Dekani – Mësimdhënësin”**. Ky vlerësim realizohet një herë brenda vitit akademik, gjegjësisht në fund të semestrit veror.

Pyetësori **“Dekani Mësimdhënësin”** përfshinë gjithsej nëntë (9) pyetje, prej tyre tetë (8) janë me mundësi përgjigje alternative, nga një listë përgjigjesh të paracaktuara (*nuk pajtohem aspak, nuk pajtohem, neutral, pajtohem, pajtohem plotësisht*). Një (1) pyetje me mundësi përgjigje Po ose Jo, dhe nëse përgjigjja është po duhet specifikuar arsye. Po ashtu, dekani dhe i vlerësuarit kanë mundësi të japin komente shtesë. Dhe në fund fare pyetësori nënshkruhet nga vlerësuesi dhe i vlerësuar, në rast se pajtohen.

Për vitin akademik 2024/2025, nga dekanët janë vlerësuar gjithsej 103 mësimdhënëse, prej tyre 71 të rregullt dhe 32 të angazhuar.

3. Procesi i vlerësimit

Procesi i vlerësimit është realizuar nga data 20 qershor deri me datë 20 korrik 2025. Fillimisht, dekanët janë njoftuar nga Zyra qendrore për sigurim të cilësisë dhe vlerësim për fillimin e procesit të vlerësimit të stafit akademik dhe periudhës vlerësuese. Pas vlerësimit të secilit prej mësimdhënëseve, dekanët kanë ftuar secilin prej tyre në mënyrë individuale për t’u njoftuar me vlerësimin, i cili vlerësim me pas është nënshkruar nga dekani dhe i vlerësuar.

Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, Koordinatorët/Zyrtarët e cilësisë kanë mbledhur dhe përpunuar të dhënat nga ky proces, të cilat janë analizuar nga Komisioni për sigurim të cilësisë dhe vlerësim në kuadër të njësive akademike. Komisioni për sigurim të cilësisë dhe vlerësim pas analizimit të procesit duke u bazuar në gjetjet e vlerësimit ka dhënë rekomandime përmirësim.

Zyra për sigurim të cilësisë dhe vlerësim në nivel qendror ka hartuar raportin përmbledhës me rezultate në nivel universiteti, ndërsa Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim ka dhënë rekomandime për përmirësim.


Për vitin akademik 2024/2025, dekanët kanë vlerësuar gjithsej 103 mësimdhënës, ku prej tyre 71 të rregullt dhe 32 të angazhuar.

Njësia akademike	Statusi i Profesorit/Asistentit		Numri i stafit akademik
Fakulteti i biznesit	Të rregullt		19
	Të angazhuar		/
Fakulteti MTHM	Të rregullt		13
	Të angazhuar		/
Fakulteti Juridik	Të rregullt		9
	Të angazhuar		/
Fakulteti i Agrobiznesit	Të rregullt		19
	Të angazhuar		18
Fakulteti i Arteve	Të rregullt		11
	Të angazhuar		14
Totali		71 të rregullt; 32 të angazhuar	

Tabelari 1: Numri i stafit të vlerësuar për pesë njësi akademike


1. Rezultatet e vlerësimit

1. Në pyetjen **“Mësimdhënësi e ka realizuar planin e punës të dorëzuar paraprakisht”**, janë dhënë gjithsej 103 vlerësime nga dekanët, me rezultatin si në vijim: 74 vlerësime (72%) janë **“Pajtohem plotësisht”**, duke treguar se në shumicën e rasteve dekanët kanë konstatuar realizim të plotë dhe korrekt të planit të punës nga mësimdhënësit. 25 vlerësime (24%) janë **“Pajtohem”**, që nënkupton se në këto raste plani i punës është realizuar sipas pritjeve dhe në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar paraprakisht. Ndërsa 4 vlerësime (4%) janë **“Neutral”**. Shumica e mësimdhënëseve kanë realizuar planin e punës të dorëzuar paraprakisht sipas pritjeve, ndërsa disa raste kanë vlerësim neutral, duke treguar mundësi për përmirësim në dokumentimin dhe raportimin e realizimit.




Grafiku 1

2. Në pyetjen **“Mësimdhënësi i përmbahet orarit të shpallur për konsultime”**, 64 vlerësime (62%) janë **“Pajtohem plotësisht”**, që tregon se shumica e dekanëve e vlerësojnë mësimdhënësin si shumë korrekt dhe të përkushtuar në respektimin e orarit të konsultimeve. 36 vlerësime (35%) janë **“Pajtohem”**, çka nënkupton një nivel të mirë përmbushjeje të këtij obligimi, edhe pse jo në shkallën më të lartë. 3 vlerësime (3%) janë **“Neutral”**, që mund të nënkuptojë se në disa raste vlerësuesit kanë pasur qëndrim të paqartë. Në përfundim, rezultatet tregojnë një pajtueshmëri të përgjithshme pozitive, me shumicën e mësimdhënëseve që vlerësohen si të rregullt në mbajtjen e orarit të konsultimeve, ndërsa përqindja e vogël e vlerësimeve neutrale sugjeron se në disa raste mund të ketë pasur mospërputhje të vogla.




Grafiku 2

3. Në pyetjen ***“Mësimdhënësi merr pjesë në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë”***, 67 vlerësime (65%) janë ***“Pajtohem plotësisht”***, që tregon se shumica e dekanëve e konsiderojnë mësimdhënësin si aktiv dhe të angazhuar në proceset e sigurimit të cilësisë. 31 vlerësime (30%) janë ***“Pajtohem”***, që nënkupton një përfshirje të mirë të mësimdhënësve në këto procese, edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të plotë. 5 vlerësime (5%) janë ***“Neutral”***, që mund të nënkuptojë se për disa raste nuk ka pasur perceptim për nivelin e përfshirjes në këto procese. Në përfundim, rezultatet tregojnë një vlerësim përgjithësisht pozitiv, duke reflektuar se mësimdhënësit në masë të madhe marrin pjesë në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë.



Grafiku 3


4. Në pyetjen **“Mësimdhënësi i përfshin studentët në aktivitetet hulumtuese”**, 61 vlerësime (59%) janë **“Pajtohem plotësisht”**, që tregon se shumica e dekanëve e vlerësojnë mësimdhënësin si aktiv në përfshirjen e studentëve në aktivitetet hulumtuese. 30 vlerësime (29%) janë **“Pajtohem”**, që tregon një nivel të mirë përfshirjeje, edhe pse jo në shkallën më të lartë. 12 vlerësime (12%) janë **“Neutral”**, që mund të nënkuptojë se për disa raste perceptimi mbi përfshirjen e studentëve nuk ka qenë i qartë. Shumica e dekanëve vlerësojnë pozitivisht përfshirjen e studentëve në aktivitetet hulumtuese. Pjesa e vogël neutrale tregon se për disa raste perceptimi ka qenë i paqartë. Në tërësi, rezultatet tregojnë një prirje kryesisht pozitive për angazhimin e studentëve në aktivitetet hulumtuese (grafiku 4).



Grafiku 4

5. Në pyetjen **“Mësimdhënësi e ka dorëzuar të rifreskuar syllabusin në fillim të vitit akademik/semestrit”**, 76 vlerësime (74%) janë **“Pajtohem plotësisht”**, që tregon se shumica e dekanëve e konsiderojnë mësimdhënësin shumë korrekt në dorëzimin e syllabusit në kohë. 26 vlerësime (25%) janë **“Pajtohem”**, që tregon një përputhje të mirë me pritshmëritë, edhe pse jo në shkallën maksimale. 1 vlerësim (1%) është **“Neutral”**, që mund të nënkuptojë një rast të veçantë ku perceptimi për dorëzimin e syllabusit nuk ka qenë i qartë.


Në përfundim, rezultatet tregojnë një vlerësim kryesisht pozitiv, me shumicën e mësimdhënëseve që dorëzojnë syllabusin të rifreskuar në fillim të vitit akademik/semestrit (grafiku 5).



Grafiku 5

6. Në pyetjen ***“Mësimdhënësi merr përgjegjësi për realizimin e detyrave (jashtë mësimdhënies dhe hulumtimit) brenda Universitetit”***, 62 vlerësime (60%) janë “Pajtohem plotësisht”, që tregon se shumica e mësimdhënësve marrin përgjegjësi të plotë dhe janë aktivë në përmbushjen e detyrave shtesë përtej procesit të rregullt mësimor dhe kërkimor. 26 vlerësime (25%) janë “Pajtohem”, çka nënkupton se një pjesë e konsiderueshme e mësimdhënësve po ashtu tregojnë përgjegjësi dhe bashkëpunim në detyrat jashtë mësimdhënies, megjithëse jo gjithmonë në të njëjtën masë apo në mënyrë të vazhdueshme si grupi i parë. 15 vlerësime (15%) janë “Neutral”, që mund të nënkuptojnë se në disa raste angazhimi i mësimdhënësve në detyra shtesë nuk ka qenë i dukshëm.


Rezultatet tregojnë një vlerësim përgjithësisht pozitiv, me shumicën e mësimdhënësve që marrin përgjegjësi për detyrat jashtë mësimdhënies dhe hulumtimit, ndërsa një pjesë më e vogël është vlerësuar neutral (grafiku 6).



Grafiku 6

7. Në pyetjen ***“Mësimdhënësi është aktiv në punime shkencore/artistike, konferenca dhe aktivitete tjera që kontribuojnë në fushën e tij akademike”***, 57 vlerësime (55%) janë **“Pajtohem plotësisht”**, çka tregon se shumica prej tyre janë shumë aktivë në punime shkencore, konferenca dhe aktivitete të tjera akademike, duke kontribuar dukshëm në zhvillimin e fushës së tyre dhe në avancimin e cilësisë akademike. 44 vlerësime (43%) janë **“Pajtohem”**, që nënkupton se edhe ky grup është i angazhuar dhe kontribues. 2 vlerësime (2%) janë **“Neutral”**, gjë që mund të nënkuptojë se niveli i angazhimit të tyre në këtë drejtim nuk është përcaktuar qartë.


Në përgjithësi, rezultatet tregojnë një nivel të mirë angazhimi shkencor të stafit akademik, duke reflektuar përfshirje të qëndrueshme në kërkime dhe aktivitete profesionale (grafiku 7).



Grafiku 7

8. Në pyetjen ***“Mësimdhënësi organizon aktivitete jashtë-kurrikulare për studentët (vizita në industri, punë praktike, vizita në institucionet relevante për lëndën e tij, etj)”***, 62 vlerësime (60%) janë **“pajtohem plotësisht”**, duke treguar që shumica absolute e tyre e sheh aktivitetin jashtë-kurrikular si të mirëorganizuar dhe efektiv. 28 vlerësime (27%) janë **“pajtohem”**, që reflekton një mbështetje të përgjithshme, edhe pse jo në nivelin maksimal. 13 vlerësime (13%) janë **“neutral”**, duke treguar se në disa raste vlerësimi i angazhimit të tyre në këtë drejtim nuk është përcaktuar qartë.

Mësimdhënësi organizon aktivitete jashtë-kurrikulare për studentët
(vizita në industri, punë praktike, vizita në institucionet relevante për
lëndën e tij, etj)



■ Nuk pajtohem aspak ■ Nuk pajtohem ■ Neutral ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht

Grafiku 8

REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM NGA KËSHILLI PËR MENAXHIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM

- Sugjerohen dekanët e njësive akademike që të kërkojnë nga personeli akademik i rregullt dorëzimin e planit vjetor të punës.
Afati kohor i implementimit: 30 nëntor 2025!
- Inkurajohen mësimdhënësit që të rrisin përfshirjen e studentëve në projektet hulumtuese.
Afati kohor i implementimit: maj 2026!
- Kërkohet nga mësimdhënësit që nuk kanë aktivitete jashtë procesit mësimor dhe hulumtimit, që të pranojnë përfshirjen në aktivitetet brenda institucionit.
Afati kohor i implementimit: I menjëhershëm!